



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 987/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Florent Zeqiri në çështjen përbarimore të kreditorit Bautex, Sh.P.K., me nr. unik identifikues 811430595, me seli në Viti, Pozhoran, që sipas autorizimit përfaqësohet nga avokat L.M. nga Ferizaj, kundër debitorit “Melodia Projekt”, Sh.P.K., me nr. unik identifikues 811023936, me seli në Shtime, Davidoc, rr. “Ibrahim Rugova”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 196/2023 të datës 23.05.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Gazmend H. Misini me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 20.12.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET në tërësi si i pa bazuar prapësimi i debitorit Melodia Projekt Sh.P.K., ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 196/2023 i datës 23.05.2023 i lejuar nga Përbaruesi Privat Gazmend H. Misini, MBETET NË FUQI.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Bautex Sh.P.K., me datë 23.05.2023 ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr.196/2023 duke lejuar përbarimin në bazë të dokumentit faturë nr. 16032023/M e datës 16.03.2023, ashtu që është detyruar debitori që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës të lartcekur, t’ia paguaj kreditorit shumë prej 3,398.40 EUR (me shkronja: tremijë e treqind e nëntëdhjetë e tetë euro e katërdhjetë euro cent) duke llogaritur edhe kamatën ligjore 8%, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar Urdhrin Përbarimor me arsyetimin se kreditori nuk ia ka bashkangjitur propozimit për përbarim faturat të cilat paraqesin dokument të besueshëm sipas dispozitave ligjore. Po ashtu ka shtuar se dokumenti në bazë të urdhrit përbarues nuk ka tipare të përbarueshmërisë sepse faturat e përshkruara në propozim debitori nuk i ka pranuar, dhe nuk është në dijeni për kohën e përmbushjes së detyrimit, dhe meqenëse të njëjtat nuk i janë bashkangjitur propozimit për përbarim faturat

nuk janë të vulosura dhe të nënshkruara nga ana e debitorit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit, si dhe të shfuqizohet urdhri përmbarimor P.nr. 196/23 i datës 23.05.2023.

Kreditori në përgjigjen ndaj prapësimit ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit në prapësim si të pa bazuara, me arsyetimin se debitori nuk ka provuar me asnjë provë materiale pretendimet e tij dhe se qëllimi i vetëm i debitorit është vonesa dhe shtyrja e përmbarimit duke krijuar rrethana të pa qena për mos t'i paguar obligimet e parapara në bazë të faturës. Ka shtuar se asnjë nga kushtet për anulimin e urdhrit për përmbarim nuk ekzistojnë, pasi që i njëjti është nxjerrë konform LPP-së, dhe faturat i plotësojnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm, po ashtu edhe vet debitori e pranon borxhin. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe ta mbetet në fuqi urdhri për lejimin e përmbarimit.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pa bazuar, andaj u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi për arsyet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - faturë nr. 16032023/M e datës 16.03.2023 e cila i përmban të gjitha elementet e kërkuara sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i këtyre faturave është përcaktuar shuma e cila përben detyrim për përmbushje nga ana e debitorit, si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi.

Tutje Gjykata konstatoi se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi dhe vula e debitorit e vënë tek pranuesi i faturës dhe e

njëjta i është bashkangjitur propozimit për përmbarrim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së, andaj është e përshtatshme për përmbarrim dhe paraqet bazë për lejimin e përmbarrimit.

Gjykata pati parasysh pretendimet e ngritura nga debitori në prapësim por gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për t'i mbështetur pretendimet e tilla, e rrjedhimisht nuk ekziston asnjëra nga shkaqet e parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarrimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 987/23 datë 20.12.2023

Gjyqtari

Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.